



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:083240

Datë: 02.09.2022

Numri i dokumentit: 03386661

P. nr.187/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtarja Diana Sina dhe me bashkëpunëtoren profesionale Kaltrina Halilaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit I. S. nga Gjakova, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë me numër PP/II.nr.104/2022 të datës 12.05.2022, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur **me datën 09.08.2022** në prani të Prokurorit të shtetit Qazim Xharra, përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit I.R., av.Avdi Rizvanolli nga Gjakova, sipas autorizimit, të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 23.08.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **I. S.**, nga i ati S. dhe e ëma F., e gjinisë G., data e lindjes . . në Gjakovë, ku edhe tani banon në rrugën “. . .”, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, atë i 3 fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal . . .

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me dt.11.12.2021 rreth orës 17:15 h, në rrugën “. . .”-Gjakovë, pikërisht në afërsi te pompa e derivateve “. . .”, i akuzuari I. S. duke drejtuar automjetin e tipit . . . me targa . . ., në kundërshtim me ligjin mbi rregullat e trafikut rrugor duke mos respektuar rregullat e lëvizjes të komunikacionit në rrugë rrezikon trafikun publik dhe jetën e tyre, në atë mënyrë që ditën kritike nga pakujdesia duke mos ju përshtat shpejtësisë së lëvizjes, kushteve dhe rrethanave të rrugës i akuzuari I. derisa ishte duke e ngasur automjetin e tij në drejtim të Prizrenit në shiritin e anës së majtë të drejtimit të rrugës me dy shirita një drejtimshe e godet të dëmtuarin I.R. i cili ishte me biçikletë në shiritin e anës së djathtë të drejtimit duke bërë kthimin majtas dhe pas goditjes rrëzohet në tokë, me ç ‘rast i dëmtuari I.R. ka pësuar lëndime të rënda trupore, të përshkruara më gjerësisht në akt ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. M.G. të datës 06.03.2022.

- Me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 e lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata në kuptim të neneve 4, 7,17 par.1, 38, 39, 40, 42, 43,44, 69, 70, 71 par.1 nën par.1.2, dhe nenit 370 par.8 lidhur me par.6 e lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarit :

I SHQIPTON

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej **90 (nëntëdhjetë) ditë**.

Me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarit konform nenit 44 të KPRK-së, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej **90 (nëntëdhjetë) ditë** i zëvendësohet me:

DËNIM ME GJOBË në shumë prej **1,000.00.-€ (njëmijë euro)**, cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPP-së, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej **50 (pesëdhjetë) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.00.-€ (njëzet euro) të gjobës**.

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej **30.00.-€**, në emër të akt ekspertimit mjeko ligjor shumë prej **20.00.-€**, në emër të ekspertizës të komunikacionit shumë prej **100.-€** , ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej **30.00.-€**, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

I dëmtuari I.R. nga Gjakova, me banim në rrugën “. . .” pa numër për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritë aktakuzën me numër PP/IL.nr.104/2022 të datës 12.05.2022,kundër të akuzuarit I. S. nga Gjakova, për shkak të veprës penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 e lidhur me par.1 të KPRK-së, duke propozuar që i njëjti të shpallet fajtor, ta dënojë sipas ligjit dhe ta obligojë në pagesën e shpenzimeve procedurale.

I akuzuari I. S., në shqyrtimin fillestar, pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana Gjykatës për pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë, lidhur me fajësinë ka deklaruar se: e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohem ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, për të cilën veprë jam penduar pa masë, duke premtuar se në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit, këtë veprë e kam kryer nga pakujdesia e jo me dashje, menjëherë pas rastit unë jam ndalur në vend aksident, aty kam lënë bashkëshorten dhe gruan e axhës ku atë natë ka qenë duke rënë shi ,por duke pasur parasysht se i dëmtuari ka pasur nevojë për ndihmë mjekësore të njëjtin e kam marrë dhe vet e kam dërguar në spital për ndihmë mjekësore, edhe pas rastit unë jam interesuar për shëndetin e tij, kam qenë në gjendje që të ndihmojë edhe financiarisht për shërimin e tij por i njëjti deri sot nuk ka kërkuar asgjë nga unë, sipas traditave tona familja ime ka shkuar në shtëpinë e familjes së të dëmtuarit, kanë kërkuar falje të cilët edhe ia kanë falur gabimin dhe tani nuk kemi asnjë mosmarrëveshje në mes veti,

edhe tani në prezencë të gjykatës kërkoj falje të dëmtuarit për lëndimet që ia kam shkaktuar dhe jam në gjendje që të kompensojë dëmin e shkaktuar. Shton se jam punëtor, mbajtës i vetëm i familjes, si dhe për herë të parë paraqitem në gjykatë për një vepër të kryer penale por premtoj se do të jetë edhe hera e fundit, andaj i propozoj gjykatës që të i merr parasysh rrethanat e lartcekura dhe të më shqiptojë një dënim sa më të butë. Në rast se gjykata do të më shqiptojë një dënim me burg deri në gjashtë muaj, i propozoj që këtë dënim të ma zëvendësojë me dënim me gjobë.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit I.R., av. Avdi Rizvanolli, ka deklaruar se: është e vërtetë se pretendime e të akuzuarit qëndrojnë për faktin se ia ka afruar ndihmën e parë gjegjësisht e ka dërguar në Spitalin Rajonal në Gjakovë, familjarët e tij pasi qëndrimit të tij 5 ditore në spital e kanë vizituar, ia ka falur veprën por i njëjti edhe sot është i paafte për punën që e ka kryer deri sot, mban qaforen dhe kohë pas kohe ka dhimbje të mëdha dhe është në kujdes të vazhdueshëm të mjekëve përkatës për çka edhe ka shpenzime në masë e cila do të vërtetohet në procedurë të mëtejme civile. Nuk i bashka ngjitemi ndjekjes penale por kërkojmë kompensim dëmi.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, Prokurori i Shtetit Qazim Xharra ka deklaruar se : duke pasur parasysh se i akuzuari e pranoi fajësinë dhe se i njëjti e ka kuptuar natyrën, pasojat dhe favorët e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht, po ashtu faktin se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes respektivisht në provat materiale dhe personale që përmban aktakuza e në bazë të të cilave është paraqitur gjendja faktike si në dispozitiv të aktakuzës PP/II.nr.104/2022 të datës 12.05.2022, me çka edhe përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, po ashtu edhe fakti se aktakuza është e ligjshme dhe se provat të cilat i përmban janë prova të nxjerra në bazë të rregullave të përgjithshme mbi provat, pra nuk janë të nxjerra në kundërshtim me kapitullin XVI të KPP-së Prokuroria e Shtetit nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Andaj edhe gjykatës i propozon që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe të i shqiptojë një dënim të paraparë me ligj duke pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së veprave penale për të cilat ngarkohet. Gjithashtu me rastin e vlerësimit të caktimit të dënimit të ketë parasysh qëllimin e dënimit, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese se i njëjti e pranoi fajësinë, qëndrimin korrekt si dhe duke pasur parasysh se në shkresat e lëndës rrjedh se këto dy familje janë pajtuar në mes veti, gjithashtu i dëmtuari nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale fakte të cilat i konfirmoi edhe përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit I.R., av. Avdi Rizvanolli, duke mos gjetur rrethana rënduese.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjyqtarja e vetme gjykuese në shqyrtim gjyqësor pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilën ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari I. S. nga Gjakova, për shkak të veprës penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 e lidhur me par.1 të KPRK-së, nga se ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale, që i vihet në barrë, pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana Gjykatës për pasojat dhe favorët e pranimit të fajësisë dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, andaj ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit. Meqenëse i akuzuari ka

pranuar fajësinë gjykata ka konsideruar se nuk do të ketë procedurë të provave e as fjalë përfundimtare.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtarja e vetme gjykuese ka vërtetuar këto gjendje faktike se:

I akuzuari I. S. nga Gjakova, ka kryer veprën penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 e lidhur me par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 370 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore e veprës penale Rrezikim i trafikut publik e kryen “*Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt dëm të konsiderueshëm pasuror*”, ndërsa në paragrafin 6 të këtij neni është përcaktuar se : “*Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia...*” kurse paragrafi 8 i këtij neni parasheh se : “*Nëse vepra penale nga paragrafi 6 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm pasuror në vlerë prej njëzetë mijë (20.000) euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet*”.

5. Vendimi për shpalljen fajtor të akuzuarit

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e ka pranuar fajësinë. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpallë fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marr për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethana rënduese Gjykata morri parasysh faktin se me kryerjen e kësaj vepre penale rrezikohet e mira juridike e mbrojtur me dispozitat penalo-juridike siç është jeta dhe trupi i njeriut, peshë e veprës penale. Ndërsa prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është baba i tre fëmijëve, mbajtës i vetëm i familjes, gjendjen e tij ekonomike, sjelljet tejet korrekte në gjykatë, pranimin e fajësisë, sjelljet e tija para dhe pas kryerjes së veprës penale, më parë nuk ka qenë i dënuar, për herë të parë paraqitet në Gjykatë për një veprë të kryer penale premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale, kërkim faljen publike të dëmtuarit për lëndimet që ia ka shkaktuar,

pajtueshmërinë e tyre, faktin se i dëmtuari nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale ,gatishmërinë e tij që të kompensoj dëmin e shkaktuar të dëmtuarit.

Andaj, duke marrë parasysh këto rrethana Gjykata konstaton se ekzistojnë rrethanat posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë, konform nenit 71 par.1 nënpar.1.2 të KPRK-së, të njëjtit fillimisht ia shqiptoi dënim me burgim prej 90 ditësh për të cilin dënim gjykata ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit e të cilin dënim, me pëlqimin e të akuzuarit konform nenit 44 të KPRK-së, dënimin me burg e ka zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 1,000.00 euro.Andaj me këtë dënim, gjykata është e bindur se do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor, është marr komfor nenit 450 par. 1 dhe 2 nën par.2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 të KPPK-se, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.187/22 me datën 09.08.2022

Bashkëpunëtorja profesionale
Kaltrina Halilaj

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Diana Sina

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.